

# **RAPORTI I VITIT 2016 PËR LIRITË FETARE NË BOTË - MAQEDONIA**

## **Përmbledhje e shkurtër**

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe garanton lirinë e fesë dhe shprehjes fetare. Ajo siguron barazi para ligjit për të gjithë individët, pavarësisht nga besimi fetar. Pesë grupe fetare janë përmendur me emër në Kushtetutë; grupet e tjera fetare mund të regjistrohen pranë qeverisë për përfitime ekuivalente me ato të pesë grupeve të përmendura. Gjykata përgjegjëse për regjistrimin e entiteteve fetare ka refuzuar një aplikim, ka pranuar një tjetër dhe ende nuk ka marrë vendimin për dy aplikime të tjera. Disa grupe fetare kanë njoftuar për favorizimin e Kishës Ortodokse Maqedonase (KOM-KO) nga qeveria. Rigjykimi i rastit për pastrimin e parave ku është përfshirë kreu i Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit (KOO) ka filluar në janar por seanca gjyqësore është shtyrë dy here. KOO e cila nuk arriti të regjistrohej si entitet fetar, ka thënë se Qeveria ka vepruar në mënyrë diskriminuese ndaj saj. Komuniteti mysliman ka raportuar se Qeveria ka refuzuar dhënien e lejes për ndërtimin ose rindërtimin e xhamive. Grupi më i madh mysliman në vend, Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni (BFI), ka përsëritur se Qeveria ka vazhduar të përgjojë në mënyrë të paligjshme krerët e saj.

Ka pasur përçarje mes kryesisë së vjetër dhe të re të BFI-së, ndërsa Komuniteti Bektashian i Maqedonisë (Tetovë) ka njoftuar sërish për shqetësime nga individë të lidhur me BFI-në. Ka pasur incidente të deklaratave anti-Semite në mediat sociale dhe akte të vandalizmit mbi lokacionet fetare. KOM-KO ka njoftuar për dhjetëra vjedhje në kishat dhe manastiret ortodokse.

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara janë takuar me përfaqësues qeveritarë, parlamentarë, të bashkësive fetare dhe shoqërisë civile, për të diskutuar çështje të tilla si liria fetare. Ambasadori ka diskutuar për tolerancën ndërfetare, rëndësinë e dialogut të hapur, dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm me zyrtarë qeveritarë dhe në paraqitje publike. Ambasada ka sponsoruar një seminar rreth lirisë fetare, i pari i këtij lloji në vend, ku kanë marrë pjesë 30 veta. Ambasada ka financuar një ligjërues nga jashtë, i cili ka diskutuar për tolerancën ndërfetare dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Ambasada, gjithashtu, ka mbështetur përpjekjet për edukimin rreth Holokaustit.

## **Pjesa I. Demografia fetare**

Qeveria e Shteteve të Bashkuara vlerëson se popullata numëron 2.1 milionë banorë (vlerësim nga muaji korrik 2016). Sipas regjistrimit të fundit shtetëror, të vitit 2002, ka rezultuar se 65% e popullatës është deklaruar se i përket besimit të krishterë ortodoks, ndërsa 33% besimit mysliman. Grupet e tjera fetare, që të gjitha së bashku përbëjnë më pak se 2% të popullsisë i përfshijnë katolikët, emërtimet e ndryshme protestante, Dëshmitarët e Jehovait dhe sipas komunitetit hebre, ka prej 200-250 hebrej.

Shumica e myslimanëve janë Sunit dhe jetojnë në pjesët veriore dhe perëndimore të vendit. Shumica e të krishterëve ortodoksë jetojnë në pjesën qendrore dhe juglindore të vendit. Ekziston ndërlidhje mes përkatësisë etnike dhe asaj fetare – shumica e të krishterëve ortodoksë janë maqedonas etnikë, ndërsa shumica e myslimanëve janë shqiptarë etnikë. Veç kësaj, shumica e romëve dhe pothuajse të gjithë turqit dhe boshnjakët janë myslimanë, ndërsa shumica e serbëve dhe vllahëve janë të krishterë ortodoksë. Ekziston edhe një lidhje midis përkatësisë fetare dhe asaj politike pasi partitë politike janë të ndara në linja etnike.

## **Pjesa II. Gjendja e respektimit të lirive fetare nga ana e Qeverisë**

### **Korniza ligjore**

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe siguron barazinë e të drejtave për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga besimi fetar. Ajo garanton lirinë e fesë dhe të drejtën e individëve për të shprehur besimin e tyre lirisht dhe në publik, në mënyrë individuale ose me të tjerët. Garanton identitetin fetar të kombësive dhe komuniteteve në vend. Shteti pranon pesë grupet fetare të përmendura në mënyrë specifike në Kushtetutë: Kisha Ortodokse Maqedonase, Bashkësia Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Metodiste Ungjillore dhe komunitetin hebre. Ligji mundëson që organizatat e tjera fetare t'i kenë të drejtat e njëjta dhe statusin ligjor si këto pesë grupe duke aplikuar për njohje nga Qeveria dhe regjistrim përmes gjykatës. Kushtetuta përcakton se pesë grupet fetare të emëtuara dhe "grupet e tjera fetare" janë të ndara nga shteti, të barabarta para ligjit dhe të lira të themelojnë shkolla, bamirësi dhe institucione të tjera shoqërore. Kushtetuta i ndalon partitë politike apo shoqatat e tjera që të nxisin urrejtje ose jotolerancë fetare.

Qeveria ka miratuar njohjen për 33 organizata fetare (duke përfshirë 16 kisha, nëntë bashkësi fetare dhe tetë grupe fetare). Pas regjistrimit, një kishë, komunitet ose grup fetar lirohet nga taksat dhe ka të drejtë të aplikojë për kthimin e pronës, projekte të financuara nga Qeveria, si dhe leje ndërtimi për ruajtjen e vendeve të

shenjta dhe vendeve kulturore. Gjithashtu, mund të themelojë edhe shkollë. Mosregjistrimi nuk e pengon grupin që të mbajë tubime ose të konvertojë, ose të rezultojë me ndëshkim dhe gjoba, por ndalon grupin që të angazhohet në aktivitete të caktuara, siç është krijimi i shkollave ose marrja e donacioneve, taksat e të cilave zbriten për donatorin.

Organizatave fetare mund të kërkojnë të regjistrohen si “kishë”, “bashkësi fetare”, ose “grup fetar”. Këto klasifikime bazohen në madhësinë e grupit, organizimin e brendshëm dhe hierarkinë e brendshme. Sipas autoriteteve gjyqësore, këto tri kategori trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit dhe nuk nënkuptojnë diferencë në të drejtat, përfitimet ose detyrimet ligjore. Gjykata Themelore Shkupi II i pranon aplikacionet për regjistrim dhe në afat prej 15 ditë pune duhet të vendosë nëse aplikacioni i organizatës fetare i përmbushë kriteret ligjore për regjistrim. Kriteret në fjalë janë: prania fizike administrative në vend; shpjegimi i besimeve dhe praktikave që e dallojnë atë prej organizatave tjera fetare, dhe emri dhe simboli i veçantë zyrtar i grupit. Një organizatë aplikuese duhet gjithashtu të identifikojë një organ mbikëqyrës përgjegjës për menaxhimin e financave të saj dhe të paraqesë kategorizimin e mjeteve financiare të saj dhe burimeve të financimit si dhe procesverbalin e kuvendit themelues të organizatës. Ligji e lejon regjistrimin e më tepër grupeve të fesë së njëjtë. Krerët e regjistruar të grupeve fetare ose përfaqësuesit e grupeve fetare duhet të jenë shtetas të vendit.

Gjykata ia dërgon aplikacionet e aprovuara Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze (KMBFGR), një organ qeveritar përgjegjës për nxitjen e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet qeverisë dhe grupeve fetare i cili i regjistron organizatat në Regjistrin e tij. Nëse aplikacioni refuzohet, organizata mund të parashtojë ankesë në Gjykatën Kushtetuese me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në bazë të diskriminimit të të drejtave fetare. Në qoftë se kërkesa refuzohet nga Gjykata Kushtetuese, organizata mund t’i ankohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

Ligji nuk i lejon grupet fetare të drejtojnë shkolla fillore private fetare, por e parashikon mundësinë në nivel të shkollimit të mesëm dhe më lartë. Ministria e Arsimit i obligon nxënësit e klasës së gjashtë dhe më lartë ta zgjedhin njërin prej tre lëndëve zgjedhore, dy prej të cilave kanë përmbajtje fetare: Hyrje në religjione dhe Etika në religjion. Sipas përkrahjes së Ministrisë, këto lëndë mbulojnë fenë në mënyrë akademike, jofetare. Lëndët zakonisht ligjërohen nga priftërinjtë apo imamët. Ministria e Arsimit thekson se të gjithë mësuesit e këtyre lëndëve marrin trajnim nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë ku ligjërojnë profesorë të filozofisë ose sociologjisë. Nëse nxënësit nuk dëshirojnë të zgjedhin

një lëndë mbi fenë, mund të zgjedhin opsionin e tretë, Kultura klasike e qytetërimit evropian.

Të gjithë të huajt që kërkojnë të hyjnë në vend për të kryer aktivitete fetare ose të kryejnë rite fetare, duhet të marrin vizë pune para mbërritjes, një proces që normalisht zgjat rreth katër muaj. KMBFGR mban një regjistër për të gjithë punonjësit e huaj fetarë dhe e ka autoritetin që t'ua miratojë ose refuzojë të drejtën për të kryer punë fetare brenda vendit. Vizat e punës janë të vlefshme për gjashtë muaj, me mundësi për zgjatje edhe për gjashtë muaj të tjerë. Përtëritja e radhës e vizës është e vlefshme për një vit. Nuk ka kufi për numrin e përtëritjeve të vizave që mund t'i lëshohen një punonjësi fetar. Klerikëve dhe punëtorëve fetarë nga grupe të peregjistruara mund t'u lëshohen viza.

Vendi është palë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike

## **Praktikat qeveritare**

Sipas profesorëve të ndryshëm universitarë, udhëheqës të organizatave joqeveritare (OJQ) dhe analistëve juridikë dhe politikë, dallimet fetare vazhdojnë të kenë rol në rastet gjyqësore penale dhe civile.

Një shembull ishte rigjykimi i kreut të Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit, Zoran Vranishkovskit, për pastrim parash i cili filloi më 28 janar, por u shty menjëherë për në 11 mars dhe pastaj u shty përsëri për të lejuar prokurorët të mbajnë seancë dëgjimore me dëshmitarët. Gjykata nuk ka caktuar një datë të re për seancë deri në fund të vitit. Në maj të vitit të kaluar, Gjykata Supreme ka anuluar dënimin për pastrim të parave për shkak të parregullsive materiale dhe procedurale dhe ka dërguar çështjen për rigjykim. Vranishkovski kishte kaluar tashmë tre vjet burg para se të lirohej në shkurt të vitit 2015. Nëse do të dënohej përsëri në rigjykim, atij do t'i llogaritej koha që tashmë ka shërbyer në burg. Përfaqësuesit e KOO kanë deklaruar se gjykimi ishte i motivuar politikisht dhe me vonesa të qëllimshme, ndërsa Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut e quajti Vranishkovskin i burgosur politik. KOO është ankuar se procesi ka qenë një persekutim fetar dhe ka deklaruar se refuzimi i gjykatës që të zhbllokojë llogaritë bankare të Shoqatës Anastasija, shoqata e regjistruar civile e KOO, ka penguar KOO të funksiononte siç duhet. Prokuroria ka deklaruar se Shoqata Anastasija ishte përdorur nga Vranishkovski për veprimtari të paligjshme. Në fund të vitit, rasti ende ishte në pritje të rigjykimit në Gjykatën Themelore Shkup 1.

Në një rast tjetër, KOO ka qenë në pritje e sipër të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, lidhur me aplikacionin për regjistrim si organizatë e njohur fetare, që është refuzuar nga gjykatat nacionale mbi bazë të pamundësisë për shpjegimin e dallimit mes emrit dhe simbolit të saj, krahasuar me ato të KOM-KO. GJEDNJ e përfundoi procesin gjyqësor, megjithatë pritet ta shpallë vendimin deri në fund të vitit. Atë Davidi nga KOO, e njohur nga Kisha Ortodokse Serbe si e vetmja Kishë Ortodokse legjitime në vend, ka deklaruar se Qeveria e ka ekspozuar KOO ndaj shqetësimeve të mediave dhe monitorimit të panevojshëm për shkak të refuzimit të tyre për të njohur pavarësinë e plotë të KOM-KO nga Kisha Ortodokse Serbe.

Gjykata Themelore Shkupi II ka pranuar katër kërkesa fetare për regjistrim dhe ka miratuar një, nga Kisha Protestante Ungjillore. Gjykata ka hedhur poshtë kërkesën e Komunitetit Bektashi të Kërçovës. Aplikimet nga Komuniteti i krishterë në Maqedoni dhe Komuniteti i myslimanëve mbetën të pazgjidhura.

Bashkësia Bektashiane e Maqedonisë (Tetovë), një urdhër sufist islam, ka vazhduar të pres një vendim nga GJEDNJ-ja lidhur me apelin e saj të vitit 2013 me të cilin ka kërkuar nga Gjykata të hedh poshtë refuzimin e Gjykatës Kushtetuese të apelimt të bashkësisë për refuzimin e regjistrimit.

Komiteti i Helsinkit ka raportuar se GJEDNJ-ja nuk ka vendosur lidhur me rastin e bektashinjve sepse ka qenë duke shqyrtuar rastin në krahasim me raste të tjera të natyrës së ngjashme para se të marrë vendimin. Bashkësia Bektashiane ka njoftuar se një zyrtar i GJEDNJ-së i kishte vizituar për të diskutuar rastin gjatë vitit. Qeveria ka vazhduar të lëshojë viza për anëtarët e huaj të Bashkësisë Bektashiane të Maqedonisë (Tetovë).

Organizatat më të vogla fetare që nuk përmenden në Kushtetutë, si Dëshmitarët e Jehovahit, Kisha Ungjillore, Bashkësia Bektashiane (Tetovë), dhe KOO, thanë se edhe pse nuk kanë qenë të regjistruara, Qeveria nuk i trajton ato si të barabartë me pesë organizatat fetare të njohura në Kushtetutë. Për shembull, ata thanë se Qeveria i ka përjashtuar nga ngjarjet zyrtare siç janë shënimet e festave shtetërore dhe ceremonitë e ndryshme përruese, dhe nuk u është dhënë i njëjti nivel i qasjes ndaj zyrtarëve qeveritarë kur kanë kërkuar takime. Veç kësaj, nga BFI, një nga pesë grupet fetare të njohura zyrtarisht në Kushtetutë, kanë deklaruar se Qeveria ka favorizuar KOM-KO duke i dhënë privilegje unike, si për shembull duke iu dhënë në dispozicion prona publike pa pagesë, fonde për ndërtimin e kishave të reja ortodokse, si dhe ftesa ekskluzive për përfaqësuesit e saj për të marrë pjesë në ngjarje qeveritare. KOM-KO ka mohuar çdo lidhje me Qeverinë dhe ka thënë se ajo nuk përfshihet në politikë.

Një mjek mysliman nga Gostivari ka njoftuar se vazhdon t'i nënshtrohet ngacmimit dhe kontrollit të panevojshëm nga policia kufitare për shkak të mjekrës së tij të gjatë dhe pantallonave të shkurtra që ai vishte për arsye fetare, me çka janë vonuar kalimet e tij kufitare sa herë që ka hyrë dhe ka dalë nga vendi.

BFI deklaroi se Qeveria ka vazhduar të parandalojë ndërtimin e një xhamie në fshatin etnikisht të përzier Lazhec duke mohuar një leje ndërtimi për shkak të presionit nga banorët lokalë të cilët kundërshtojnë ndërtimin e xhamisë. BFI ka njoftuar se Qeveria ka vazhduar gjithashtu të bllokojë rindërtimin e xhamisë në Prilep, e cila u dogj gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2001. Sipas BFI, Qeveria e ka refuzuar lejen për rindërtimin e xhamisë me arsyetimin se Prilepi ka qenë një monument i kulturës fetare.

Grupet fetare, duke përfshirë komunitetet myslimane dhe katolike, kanë raportuar se kthimi i pronës së konfiskuar më parë nga shteti paraqet problem. Për shembull, në fund të vitit, BFI ende kërkonte të drejtën e pronësisë mbi Jeni Xhaminë në Manastir, të cilën shteti e ka shpallur monument të kulturës fetare dhe ka marrë pronësinë në vitin 1950. Kisha Katolike gjithashtu i ka bërë thirrje Qeverisë të denacionalizojë një pronë të konfiskuar para epokës komuniste në fshatin jugor të Paliurcit, ku donte të ndërtonte një kishë dhe një manastir. Mosmarrëveshja mbi pronën e Paliurcit ka ngecur në gjykata për 10 vjet.

Duke iu përgjigjur një kërkesë të vitit 2015 nga zyra e Avokatit të Popullit, Inspektorati i Ministrisë së Arsimit ka ngritur hetime dhe ka vendosur që një marsh studentor i organizuar nga një shkolle publike në Manastir për të festuar atë që mediati e quajti "festat e mira ortodokse" nuk ka qenë një aktivitet i planifikuar. Inspektorati i ka paralajmëruar katër shkollat fillore dhe stafin e tyre mësimor.

Udhëheqja e BFI ka vazhduar të raportojë se besonte se telefonat e liderëve të saj po përgjoheshin ilegalisht.

Grupet e shoqërisë civile, si Komiteti i Helsinkit dhe komunitetet më të vogla fetare, duke përfshirë Kishën Ungjillore Protestante dhe Bektashianët, thanë se Qeveria kishte ndërhyrë në çështjet fetare dhe shpesh ka politizuar fenë. Për shembull, më 15 shkurt, zyrtarë qeveritarë, duke përfshirë Kryeministrin Emil Dimitriev, ministra, kryetarë të komunave dhe deputetë nga partia në pushtet Organizata Revolucionare e Brendshme e Maqedonisë- Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar (VMRO-DPMNE), kanë marrë pjesë në ceremoninë e përirimit për fillimin e ndërtimit të një kisha të stilit rus të KOM-KO-së dhe kompleks ndërtesash shoqëruese në lagjen Zhelezara të Shkupit. Zyrtarët e qeverisë qendrore dhe lokale kishin lehtësuar më parë ndërtimin dhe marrjen e tokës dhe lejeve nga KOM-KO.

Më 28 shkurt, policia ka ndërhyrë për të parandaluar përplasjen mes anëtarëve të KOM-KO dhe myslimanëve që kanë kundërshtuar ndërtimin e një kryqi 55 metra të gjatë në Butel, një komunë etnikisht e përzier shqiptare dhe maqedonase e Shkupit. Kryetarja e KMBFGR u ka bërë thirrje qytetarëve që të shmangin konfrontimet ndërsa vëzhguesit e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) kanë ndihmuar ndërmjetësimin e një marrëveshje me të cilën është ndërprerë ndërtimi i kryqit. Në shtator, Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë një iniciativë të partisë politike Lëvizja për Reformat - Partia Demokratike Shqiptare (LR-PDSH) për të vlerësuar ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e ndërtimit të kryqit, duke dhënë si bazë mungesën e juridiksionit.

Departamenti i Ministrisë së Drejtësisë për Legjislacionin Penal dhe Civil, me ndihmën e OSBE-së, ka punuar në hartimin e një projektligji të ri për krime nga urrejtja që përfshin veprime të motivuara nga feja. Në fund të vitit, projektligji ende nuk ishte përfunduar.

KMBFGR ka njoftuar se kishte lëshuar pëlqime për të gjithë misionarët e huaj dhe klerikët të cilët kishin paraqitur kërkesa për punë fetare gjatë vitit.

### **Pjesa III Gjendja e respektimit shoqëror të lirive fetare**

Në prill, ish-sekretari i përgjithshëm i BFI dhe ish myftiu i Shkupit kanë ngritur akuza kundër udhëheqjes aktuale të BFI, duke pretenduar se shkarkimi i tyre në vitin 2015 ka qenë i paligjshëm. Në nëntor dhe dhjetor, Gjykata Penale në Shkup ka hedhur poshtë akuzat kundër udhëheqësisë aktuale të BFI. Në një rast të veçantë që lidhet me këto shkarkime, BFI ka kërkuar nga Qeveria të ndjekë penalisht 27 individë për përfshirje në një sulm të armatosur të vitit 2015 dhe pushtimin 13-ditor të ambienteve të BFI. Më 4 nëntor, Gjykata Penale në Shkup ka shpallur fajtorë 23 persona dhe i ka dënuar me tre muaj me kusht. Të pandehurit ankuan vendimin, dhe ankesa ishte në pritje në fund të vitit. BFI ka deklaruar se dënimi ka qenë shumë i butë.

Bektashinjtë kanë vazhduar të njoftojnë për incidente të shqetësimit nga pjesëtarët e BFI-së, të cilët e kanë okupuar kompleksin Harabati Baba Teqe në Tetovë. Përfaqësuesit bektashianë kanë raportuar se shpeshherë ata dhe vizitorët ishin shqetësuar verbalisht, duke thënë se bandat e BFI-së u kishin thënë të largohen nga kompleksi.

Ka pasur raste të fjalimit antisemit në mediat sociale. Milenko Nedellkovski, gazetar, ka postuar dy herë komente ofenduese për komunitetin hebre. Ai ka thënë se hebrenjtë Ashkenazi kontrollonin pjesën më të madhe të botës dhe i ka përshkruar ata si "ideologë, financierë dhe organizatorë të Holokaustit" dhe si

"krijues të perceptimit se hebrenjtë kanë qenë viktimat më të mëdha të nazistëve". Komuniteti hebraik nuk është përgjigjur publikisht për postimet, duke raportuar se ata kanë dashur të tërheqin vëmendjen edhe më tepër ndaj shkrimeve të Nedellkovskit.

Në një deklaratë, si përgjigje ndaj sulmeve terroriste të Brukselit, BFI ka dënuar çdo manipulim dhe sjellje kriminale në emër të Islamit. BFI u ka bërë thirrje të gjithë besimtarëve myslimanë të "bashkohen me vendet perëndimore dhe të bashkërendojnë të gjitha veprimet kundër të gjithë terroristëve".

Fondi i Holokaustit i hebrenjve nga Maqedonia, një OJQ, ka vazhduar të punojë me Ministrinë e Arsimit për të zbatuar programe mësimore të historisë hebraike dhe për të promovuar bashkëpunimin ndërfaqetarak. Ky projekt i ka pajisur mësimmhendhësit me mjete për t'i mësuar nxënësit e shkollave të mesme rreth historisë së Holokaustit dhe hebrenjve.

Ka pasur raporte për vandalizëm në vendet fetare. Në maj, vandalë të panjohur kanë grabitur dy xhami në Tetovë. BFI ka thënë se nuk donte t'u jepte shumë publicitet incidenteve të vogla, duke u përpjekur që të mos nxisë ekstremizmin ose për të shmangur probleme shtesë. Në shkurt, autorë të panjohur kanë vjedhur ikona nga një kishë e KOM-KO në Dellçevë, dhe në prill individë të panjohur kanë dëmtuar ambientet e një kishë të vjetër të KOM-KO në Dibër, ndërkohë që sipas KOM-KO dhe raporteve të medias, duket se ata kanë gërmuar flori.

KOM-KO ka njoftuar për një sërë plaçkitjesh në kishat dhe manastiret ortodokse anembanë vendit. Këto plaçkitje, para së gjithash, kanë pasur të bëjnë me paratë e grumbulluara nga donacionet dhe nga një numër i vogël i objekteve të trashëgimisë kulturore siç janë ikonat. Policia ka kryer disa arrestime në lidhje me plaçkitjet në kisha në shkurt dhe tetor. Përveç kësaj, në maj autoritetet kanë arrestuar një shtetas serb të dyshuar për vjedhje në një kishë, ndërsa është përpjekur të kalonte kufirin me Serbinë.

#### **Pjesa IV Politika qeveritare e Shteteve të Bashkuara**

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara, është takuar me Ministrin e atëhershëm të Drejtësisë Adnan Jashari në mars, ndërsa zyrtarë të ambasadës janë takuar me Ministrin e Drejtësisë Valdet Xhaferi në shtator për të diskutuar projektligjin e ri për gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes, që përfshin gjuhën e urrejtjes dhe krimet kundër caqeve fetare.

Ambasadori, gjithashtu, ka diskutuar për tolerancën ndërfaqetarak, rëndësinë e dialogut të hapur dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm me zyrtarë të lartë



qeveritarë, përfshirë Ministrin e Brendshëm Oliver Spasovski dhe Drejtorin në Ministrinë e Punëve të Jashtme Abdulkader Memedi, dhe në shfaqjet publike, duke përfshirë një konferencë për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut - Kërcënimet Transnacionale ndaj Sigurisë.

Ambasadori është takuar me kreun e BFI-së në shkurt dhe qershor për të diskutuar çështje të lirisë fetare, siç janë ndërhyrja politike dhe favorizimi, dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm. Një zyrtar i ambasadës është takuar me përfaqësues nga bashkësitë më të vogla fetare, si bektashinjtë, të krishterët ungjillorë, dhe Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme (Mormonët) dhe shoqëria civile, përfshirë Komitetin e Helsinkit dhe Institutin Ballkanik për Besimin dhe Kulturën, për të diskutuar lirinë fetare.

Në shtator, ambasada dhe disa agjenci qeveritare të SHBA-ve kanë bashkë financuar një seminar tre-ditor për lirinë fetare. Pjesëmarrësit kanë përfshirë udhëheqës fetarë, gjyqtarë, prokurorë, zyrtarë të zgjedhur dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Ambasadori ka folur në hapjen e seminarit, duke theksuar rëndësinë e tolerancës fetare dhe duke inkurajuar pjesëmarrësit që të avokojnë për tolerancë në sferat e tyre të ndikimit. Seminari është përqendruar në atë se si grupet fetare dhe OJQ-të mund të avokojnë për lirinë fetare dhe tolerancën me bashkëbiseduesit e Qeverisë dhe si të parandalojnë dhunën e motivuar nga feja. Shumë pjesëmarrës e kanë vlerësuar lartë trajnimin dhe janë ankuar se në vend nuk ekzistojnë forume të tjera që ndihmojnë dialogun e hapur për tolerancën fetare midis palëve të interesuara. Ambasada, gjithashtu, ka financuar një fushatë të ndërgjegjësimit publik dhe një program shkollor për rritjen e tolerancës, mirëkuptimit dhe respektit fetar midis shqiptarëve etnikë (kryesisht myslimanë) dhe maqedonasve etnikë (kryesisht të krishterë ortodoksë). Programi ka ofruar trajnime për vlerësimin e diversitetit për mësuesit dhe nxitje për shkollat për të përfshirë integrimin ndëretnik në aktivitete jashtëshkollore.

Në nëntor, ambasada ka pritur një ekspert amerikan për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe tolerancës fetare. Ai ka diskutuar me krerët e Qeverisë, liderët e partive politike, mediat dhe BFI (të dy krerët dhe imamët) për rëndësinë e dialogut dhe tolerancës fetare si mënyrë për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm.

Ambasada ka mbështetur Fondin e Holokaustit të hebrenjve të Maqedonisë me një grant të vogël, me të cilin është financuar një seminar për mësuesit mbi historinë e hebrenjve sefardikë dhe Holokaustin dhe janë mbuluar shpenzimet për tre pjesëmarrës në një akademi verore të fokusuar në Holokaustin në Vjenë, Pragë dhe Berlin.